

VENDIM
Nr. 230, datë 17.4.2019

PËR SHPALLJEN, KATEGORIZIMIN DHE EMËRTIMIN E PORTIT TË LLOJIT MBM, NË PORTO-ROMANO, DURRËS, “PORT I HAPUR PËR TRAFIK NDËRKOMBËTAR”

(ndryshuar me VKM nr. 324, datë 2.6.2021)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 18, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen, kategorizimin dhe emërtimin e portit detar të llojit MBM (*Multi Buoy Mooring*), në Porto-Romano, Durrës, si “Port i hapur për trafik ndërkombëtar”, i cili i ka specifikat, si më poshtë vijon:

a) Koordinatat gjeografike	<i>Pika A: N- 41° 22'18.532" E- 19° 23'31.052"</i> <i>Pika B: N- 41° 21'48.277" E- 19° 23'46.517"</i> <i>Pika C: N- 41° 21'36.625" E- 19° 23'6.361"</i> <i>Pika D: N- 41° 22'6.877" E- 19° 22'50.891"</i> <i>Pika P1: N- 41° 22'32.520" E- 19° 25'19.200"</i> <i>Pika P2: N- 41° 22'25.07148" E- 19° 24'49.41114"</i> <i>Pika P3: N- 41° 22'33.29830" E- 19° 25'18.43707"</i> <i>Pika P4: N- 41° 21'49.92000" E- 19° 24'32.30000"</i> <i>Pika P5: N- 41° 22'50.48000" E- 19° 24'35.27000"</i> <i>Pika P6: N- 41° 22'15.47132" E- 19° 25'06.45369"</i> <i>Pika P7: N- 41° 22'08.19861" E- 19° 24'47.41062"</i> <i>Pika P8: N- 41° 22'07.89630" E- 19° 24'43.12646"</i> <i>Pika P9: N- 41° 22'09.16808" E- 19° 24'38.71361"</i> <i>Pika P10: N- 41° 22'12.34902" E- 19° 24'34.95584"</i> <i>Pika P11: N- 41° 22'16.33018" E- 19° 24'33.96351"</i>
b) Veprimtaria detare	<i>Ngarkim-shkarkim i mjeteve lundruese që transportojnë naftë, gaz dhe nënproduktet e tyre, si dhe mallra të tjera, në përputhje me parashikimet e marrëveshjes koncesionare, të ndryshuar, të miratuar me ligjin nr. 104/2015, të ndryshuar.</i>
c) Operativiteti	Port i hapur për trafik ndërkombëtar, 24 orë;
ç) Shfrytëzimi	Faza I: Sipas marrëveshjes koncesionare të ndryshuar, gjatë kohëzgjatjes së koncesionit miratuar me ligjin nr. 104/2015, i ndryshuar; Faza II: Pronë e shtetit shqiptar dhe e lirë për t'u shfrytëzuar sipas vullnetit të shtetit, pas përfundimit të koncesionit;
d) Menaxhimi	Faza I: Shoqëria koncesionare “Porti MBM (<i>Multy Buoy Mooring</i>)” sipas marrëveshjes koncesionare të ndryshuar, miratuar me ligjin nr. 104/2015, i ndryshuar, gjatë kohëzgjatjes së koncesionit; Faza II: Shteti shqiptar, përfaqësuar nga organet qendrore përgjegjëse, në fushën e porteve dhe zhvillimit ekonomik;

dh) Pronësia	Shteti shqiptar, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave. Kufizime: Në përdorim të shoqërisë koncesionare “Porti MBM (<i>Multy Buoy Mooring</i>)” Porto Romano, Durrës, gjatë kohëzgjatjes së koncesionit;
e) Marrëdhënia me institucionet përgjegjëse për transportin dhe energjinë	Raportim periodik për vëllimin e punës së kryer në port;
ë) Detyrime të tjera	Person kontakti dhe adresë kontakti në çdo kohë. Faqe zyrtare në gjuhën shqipe dhe në anglisht që përmban informacion të plotë për rregullat e funksionimit të portit, tarifat dhe normat ditore të ngarkim-shkarkimit, si dhe informacion për situatën e anijeve në port.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të marrin masa që në bashkëpunim me drejtuesit e portit të bëjnë funksionale të gjitha strukturat përkatëse shtetërore, përfshirë komunikimin nominal të personave që do t’i ushtrojnë këto funksione në port.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe